

Priština që nga viti 1971. Me familje jetonin në lagjen *Ulpiana*. Dejeni jetonte te prindërit e vet në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Punonte si elektrikist në mihjen sipërfaqësore *Bardhi i Madh/Belaćevac*. Nga viti 1998, ai ka qenë i angazhuar si shofer në forcat rezervë të policisë serbe. Në datën **6.11.1998**, rreth orës 11:00, Ilija dhe Dejeni u nisën me një kamion të tipit *Dajc* për në Malishevë/Mališevo, ku rregullisht bartnin ushqime për forcat policore. Sipas versionit zyrtar, ata u ndalën nga pjesëtarët e UÇK-së në rrugën **Malishevë/Mališevo** – Arllat/Orlate [Glllogoc/Glogovac], të cilët i çuan në drejtim të panjohur. Dy ditë më vonë, pas sulmit të UÇK-së mbi stacionin policor në Malishevë/Mališevo, trupat e tyre të pjetë të gjetën te shkolla, buzë rrugës Malishevë/Mališevo – Banjë/Banja. I kishin vlarë me armë zjarri. Dejanin e kanë varrosur më 7.11.1998 në varrezat e Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Familjarët i kanë transferuar mbetjet e tij mortore të tij më 25.04.2006 në varrezat e Novi Knezevcit. Ilijën e kanë varrosur në Podgoricë, në Mal të Zi.

Burimet: deklarata L.D, FDH-36380; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), D290.25, FDH-30817; SMIP, *Teroristički...*, III, 942; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 20, 23; Z. Stijović, *Kosmet...*, 92, 93; Sindikat radnika JP Elektrokosmet, *Stradanja...*, 8; M. Mijalkovski, *Terorizam...*, 51; *Another Kosovo Cover-Up*, The Wall Street Journal, 10.11.1998, <http://www.truthinmedia.org/Activism/wsj11-10.htm>; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Bodies of Two Policemen Found Near Malisheva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 09.11.1998, FDH-30643.

Xhafer (Sefë) Gashi

(20.07.1950, shqiptar nga Mleqani/Mleçane,

komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, shtatë fëmijë)

Xhaferi me bashkëshorten Hamiden, fëmijët, vëllezërit me familjet e tyre e kanë braktisur Mleqanin/Mleçane më 27.07.1998. Së pari shkuan në fshatin Tërdec/Trdevac [Glllogoc/Glogovac], dhe, më pas, në Negroc/Negrovac [Glllogoc/Glogovac]. Në fillim të muajit gusht, shkuan dhe u strehuan në pyll mbi fshatin Golluboc/Golubovac. Atje, forcat serbe më 26.09.1998 e ndanë Xhaferin dhe burrat e tjerë nga familjarët e tyre [të shikohet regjistrimi], por më vonë e liruan. Në **Mleqan/Mlečan** u kthyen më 28.10.1998. Kohë pas kohe, përreth fshatit dëgjoheshin të shtënat. Në datën **12.11.1998**, të shtënat u rritën në intensitet. Xhaferi doli për një çast që të blinte diçka në shitoren e fshatit. Menjëherë pas daljes së tij nga shtëpia, e ëma dhe bashkëshortja e tij kanë dëgjuar të shtënat dhe zhurmën e automobilit. E bija Lindita doli jashtë dhe pranë kapisë e geti të atin e plagosur dhe të përgjakur tërësisht. Vëllai i Xhaferit, Osmani, me komshinjtë e futën menjëherë Xhaferin në një makinë dhe u nisën për në ambulancën e UÇK-së në Bajicë/Banjica [Glllogoc/Glogovac]. Xhaferi ndërroi jetë në rrugë e sipër. Në mbrëmje, pjesëtarët e UÇK-së e kanë varrosur Xhaferin në varrezat e *Mëhallës Shala* në Mleqan/Mleçane. Në muajin tetor të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Xhaferit në varrezat familjare.

Burimet: deklarata H.G, FDH-16616; *One Albanian Killed and Several Wounded in Serb Attack on Mlečan Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 12.11.1998, FDH-30647; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242.